# SYLLABUS I LËNDËS " E DREJTA E PROCEDURËS CIVILE II"

| **Të dhëna bazike të lëndës** | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | **Fakulteti Juridik** |
| **Titulli i lëndës:** | **E Drejta e procedurës civile II, pjesa jokontestimore** |
| **Programi:** | **Juridik i përgjithshëm** |
| **Niveli:** | **Bachelor** |
| **Statusi lëndës:** | **Obligative** |
| **Viti i studimeve:** | **III** |
| **Numri i orëve në javë:** | **3+2** |
| **Vlera në kredi – ECTS:** | **7** |
| **Koha / lokacioni:** | **Koha/lokacioni (termini i mbajtjes së ligjëratës dhe salla), si dhe detaje të tjera do te caktohen në bashkëpunim me Fakultetin** |
| **Mësimdhënësi i lëndës:** | **Prof. Asoc. Dr. Berat Aqifi** |
| **Të dhënat kontaktuese:** | **e-mail: berat.aqifi@uni-prizren.com** |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës:** | E drejta procedurale civile II - Procedura Jokontestimore merret me studimin e rregullave juridike, si lloj i posaçem i procedurës gjyqësore civile e cila i është përshtatur karakteristikave specifike të raporteve juridiko-civile që shqyrtohen dhe për të cilat vendoset në këtë procedurë me anë të cilave rregullohet: struktura e procedurës jokontestimore, pozita dhe roli i subjekteve procedurale, aktivitetet procedurale të tyre si dhe raportet reciproke midis tyre. Procedura jokontestimore është lloj i posaçem i procedurës gjyqësore civile e cila i është pershtatur karakteristikave specifike te raporteve juridiko-civile te cilat hyjne ne kompetencen gjyqesore me ligjin per proceduren jokontestimore i Kosoves i vitit 2008 dhe ate: procedurat sipas te cilave rregullohet statusi personal apo statusi familjar dhe procedurat sipas te cilave rregullohet menyra e vendosjes mbi raportet pasurore-juridike dhe mbi raportet tjera te ngjajshme. Poashtu, do të trajtohet edhe procedura përmbarimore si procedurë gjyqësore civile për realizimin apo sigurimin e kërkesave pasurore-juridike, juridiko familjare, nga marrëdhënia e punës dhe kërkesave tjeraqë vihet në veprim në bazë të vendimit përfundimtar të procedurës kontestimore me të cilin gjykata e ka detyruar të padituri që të sillet në mënyrën e caktuar. |
| | |
| **Qëllimi i lëndës:** | Ligjëratat do të ofrohen duke respektuar format e avancuara për mësimdhënie. Do të zbatohet metodologjia interaktive, e cila prezumon aktivitet si nga ana e mësimdhënësit ashtu edhe të studentëve. Metodologjia e ligjërimit do të orientohet në krijimin e mundësive te studentët për të zotëruar dhe fituar njohuritë për të drejtën e procedurës civile pozitive. Do |

| | |
|---|---|
| | të pretendohet në shtjellimin e qartë e të saktë teorik të instituteve juridike në të drejtën e procedurës civile jokontestimore. Ofrimi i shembujve nga praktika gjyqësore do të ketë për qëllim arritjen e shkallës së aftësimit të studentëve për interpretimin e ligjit dhe krijimin e opinionit ligjor.<br>Aspektet komparative nga të drejtat e vendeve të tjera do të ofrohen vetëm në rastet e nevojshme për të plotësuar zbrazëtitë teorike të së drejtës procedurale civile jokontestimore dhe përmbarimore në Kosovë dhe për të avancuar njohuritë juridike. Interpretimi i ligjit nuk paraqet qëllim në vete. Shumë më tepër, përmes interpretimit ligjor pretendohet arritja e një konkluzioni. Deri te arritja e konkluzionit për një problem juridik do të duhej të respektohej skema e caktuar.<br>Në këtë kuptim, studentët do të aftësohen që të jenë në gjendje për të krijuar opinionin juridik lidhur me një çështje dhe për të arritur te një konkluzion, i cili ka bazën ligjore dhe nuk bie ndesh me legjislacionin në fuqi.<br>Theks të veçantë do t´i kushtohet aftësimit për analizë juridike në bazë të argumenteve. |
| | |
| **Rezultatet e të nxënit**: | Pas perfundimit me sukses te provimit , studentët nga kjo lëndë do të përfitojnë :<br>• njohuri teorike mbi konceptet e të Procedurave jokontestimore dhe Përmbaruese<br>• njohuri praktike mbi hulumtimin, analizimin dhe zbatimin e Legjislacionit vendor në fushën e të Procedurave jokontestimore dhe Përmbaruese<br>• aftësi që të përpilojnë opinione ligjore ne qështjet procedurale |

| **Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)** | | | |
|---|---|---|---|
| **Aktiviteti** | **Orë** | **Ditë/javë** | **Gjithsej** |
| Ligjërata | 3 | 15 | 40 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 2 | 15 | 30 |
| Punë praktike | 1 | 15 | 15 |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 10 min | 15 | 1.5 |
| Ushtrime në terren | 4 | 4 | 16 |
| Kollokfiume, seminare | 1 | 1 | 1 |
| Detyra të shtëpisë | 2 | 13 | 26 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 2 | 15 | 30 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 2 | 15 | 30 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final) | 4 | 1 | 4 |
| Projektet, prezantimet ,etj | 10 | 1 | 10 |
| **Totali** | | | **200 orë (7 ECTS)** |
| **Metodologjia e mësimdhënies:** | Në kuadër të programit të lëndës, metodë kryesore e vlerësimit mund të jetë:<br>• Prania në ligjërata krahasuese;<br>• Konsultime;<br>• Ushtrime të realizuara me sukses;<br>• Testi me shkrim-me gojë;<br>• Punë praktike e realizuar;<br>• Punimet seminarike;<br>• Punë në terren;<br>• Projekte të realizuara në punëtorit edukative; | | |
| **Metodologjia e vlerësimit:** | **Kollokium dhe provim final**<br> Vlerësimi i parë: 30%<br> Vlerësimi i dytë 25%<br> Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10%<br> Vijimi i rregullt 5%<br> Provimi final 30%<br> Total 100%<br>**Vlerat e pikëve:**<br>Provimi ka 100 pikë.<br>50-60 = 6; 61-70 = 7; 71-80 = 8; 81-90= 9; 91-100 = 10<br>Pikët nën 50 nuk mbërrijnë notën kaluese. | | |
| **Literatura** | | | |
| **Literatura primare:** | - **Mustafë Musa, E drejta procedurale II, Gjilan 2016;**<br>- Brestovci, Faik, E drejta procedurale civile II, Prishtinë 2oo4;<br>**Ligjet:**<br>- Ligji për procedurën kontestimore, Ligji Nr. 03/L-006, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 30.06.2008, shpallur me dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës më 29.07.2008;<br>- Ligji për procedurën përmbarimore, Ligji Nr. 03/L-008, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 02.06.2008, shpallur me dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës më 26.06.2008; | | |
| **Literatura shtesë:** | Ligji për procedurën përmbarimore, Ligji Nr. 2012/04-L-139, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës | | |

| | |
|---|---|
| | më 20.12.202, shpallur me dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës më 03.01.2013: shiko nenin 402<br>- Ligji për procedurën jokontestimore, Ligji Nr. 03/L-007, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 20.11.2008, shpallur me dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës më 13.12.2008:<br>- Ligji për gjykatat;<br><br>- Disa materiale të përgatitura nga USAID (do të shpërndahen në formën elektronike) - Morina, Iset/Nikqi, Selim, LPK-Komentar, Prishtinë, 2012; |

| **Plani i dizajnuar i mësimit:** | | |
|---|---|---|
| **Java** | **Ligjërata** | **Ushtrime** |
| *Java e parë:* | Hyrje dhe parimet e së drejtës së procedurës jokontestimore | Hyrje prezentim i lëndës |
| *Java e dytë:* | Veprimet procedurale | Diskutim rreth veprimeve procedural |
| *Java e tretë:* | Procedurat për rregullimin e gjendjes personale | Elaborim i procedures për rregullimin e gjendjes personale |
| *Java e katërt:* | Procedurat për rregullimin e çështjeve pasurore | Diskutim përmes rastit praktik lidhur me procedurën për rregullimin e çështjeve pasurore. |
| *Java e pestë:* | Procedurat tjera jokontestimore | Rast praktik, lidhur me procedurat e tjera jo kontestimore |
| *Java e gjashtë:* | Mjetet e goditjes.<br>- Mjetet e rregullta dhe<br>- Mjetet e jashtëzakonshme | Vështrim i posaçëm i mjeteve të goditjes së vendimit në procedurë civile jokontestimore |
| *Java e shtatë:* | Kolokuiumi I-rë | Kolokuiumi I-rë |
| *Java e tetë:* | Hyrje në të drejtën e procedurës përmbarimore | Prezentim I lëndës së procedures përmbarimore |
| *Java e nëntë:* | Zhvillimet aktuale në të drejtën e procedurës përmbarimore | Diskutim rreth zhvillimit actual të procedures civile përmabrimore |
| *Java e dhjetë:* | Bazat e së drejtës së procedurës përmbarimore | Rast praktik lidhur me bazat e së drejtës së procedurës përmbarimore. |

| | | |
|---|---|---|
| *Java e njëmbëdhjetë:* | Parimet e së drejtës së procedurës përmbarimore | Diskutim bazuar në parimoet e së drejtës së procedures civile përmbarimore. |
| *Java e dymbëdhjetë:* | Subjektet e procedurës përmbarimore | Rast praktik lidhur me subjektet e procedures civile përmbarimore. |
| *Java e trembëdhjetë:* | Procedura e ekzekutimit;<br>- Kërkesa dhe baza për caktimin e ekzekutimit | Diskutim rreth procedures së ekzekutimit. |
| *Java e katërmbëdhjetë:* | Mjetet e goditjes së vendimeve në procedurën e ekzekutimit;<br>- Zbatimi i ekzekutimit;<br>- Procedura siguruese | Diskutim lidhur me mjetet e goditjes së vendimeve në procedurë përmbarimore. |
| *Java e pesëmbëdhjetë:* | Kollokuiumi II-të | Kollokuiumi II-të |

**Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

- Respektimi i orarit në ligjërata dhe ushtrime
- Mos lëshimi i sallës gjatë ligjëratave ose ushtrimeve;
- Ruajtja e integritetit akademik;
- Ruajtja e disiplinës gjatë procesin mësimor;
- Respektimi i rregullave gjatë provimit.